

Sqarim: Duhet ta përgatitni një Profaturë Eksporti në format Word ose Excel, ku dërguesi-eksportuesi duhet të jetë Kompania e juaj, ndërsa pranuesi-importuesi mund të jetë ndonjë Partner i juaji nëse e keni në Kosovë ose nëse nuk keni partner në Kosovë që e bën importin e produkteve tuaja, atëherë pranuesi-importuesi duhet të jetë Organizatori i Panairit: CEO-Congress & Event Organization, dhe po këtë profaturë duhet ta dërgoni paraprakisht në email-in e CEO-së: info@ceokos.com, më së voni 15 ditë pune para hapjes së Panairit.

Me këtë rast duhet të përgatitet një Garancion Bankar - Doganor për Import të përkohshëm nga Importuesi me vlerën: 29.8% të shumës totale të Profaturës. Këto mjete sipas rregullave bllokohen nga Banka për një interval të caktuar kohor që në rast se malli i prezentuar në Panair nuk kthehet mbrapa - nuk eksportohet nga Kosova pas Panairit, atëherë dogana me anë të Garancionit Bankar e ka të drejtën që si mbulesë ti tërheqë mjetet nga xhirollogaria e importuesit. Ndërsa nëse respektohen rregullat e Importit të përkohshëm, që nënkupton se malli i importuar eksportohet nga Kosova brenda afatit të caktuar në Garancion Bankar që është max 3 ditë pas mbylljes së Panairit, atëherë mjetet e bllokuara lirohen, dhe me këtë rast konkludohet se të dy palët i kanë respektuar rregullat e parapara me ligj sipas Doganës së Kosovës.

- Shërbimet e Bankës për Garancion Bankar janë: ===== =100 € + 18 % TVSH

- Shërbimet e Kompanisë Shpeditere e cila e përgaditë dokumentacionin e importit dhe eksportit janë: ===== =150 € + 18 % TVSH

Kompania Shpeditere e Autorizuar nga Organizatori i Panairit CEO-Congress & Event Organization:

INTEREUROPA KOSOVA L.L.C.

Mr. Jeton Vokshi
Forwarding Manager
Phone: +381 38 544 741
Fax: +381 38 544 734
Gsm: +377 44 137 935
E-mail: jeton.vokshi@intereuropa.si
www.intereuropa.si

Pikat kufitare:

Pika kufitare: Hani i Elezit -Terminal
Pika kufitare: Vërmicë-Prizren -Terminal
Pika kufitare: Merdare-Podujeva -Terminal
Pika kufitare: Mitrovica -Terminal
Pika kufitare: Aeroport - Prishtinë
Pika kufitare: Kullë - Pejë
Pika kufitare: Dheu i bardhë - Gjilan

Për më shumë informata ju lutem vizitoni web faqen e Doganës së Republikës së Kosovës: www.dogana-ks.org